

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Letërnjoftimi i Komunës së Gjakovës 2013

Janar, 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje .....	4
2. Problemet në Komunën e Gjakovës.....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Gjakovës.....	6
4. Investimet kapitale .....	12
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik .....	14
6. Administrata e Komunës së Gjakovës.....	15
7. Arsimi në Komunën e Gjakovës.....	16
8. Shëndetësia në Komunën e Gjakovës .....	18
9. Transparenca në Komunën e Gjakovës .....	18
10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	20
11. Burimet:.....	23

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Gjakovës e cila udhëhiqet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) gjatë tri viteve të fundit (2010-2012) ka treguar vullnet për t'i adresuar nevojat dhe kërkesat e banorëve të kësaj komune, ndonëse akoma disa problemet mbesin evidente. Gjatë tri viteve të fundit, progresi i shënuar në disa fusha është përcjellë edhe me shkelje të normave ligjore si dhe me shpërfillje të rregullave në fushën e prokurimit publik.

Gjatë tri viteve të fundit, Komuna e Gjakovës ka rritur nivelin e transparencës komunale si dhe të investimeve kapitale, por mbetet e pashpjegueshme niveli i lartë i shpenzimeve të parasë publike në disa kategori dhe nga disa drejtori. Nga të dhënat zyrtare rezulton se Drejtoria e Kulturës shpenzon para shumëfish më shumë se Zyra e Kryetarit dhe disa drejtori të tjera. Për shembull, Drejtoria e Kulturës për mirëmbajtjen e objekteve gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 62.789 euro, përderisa Drejtoria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit së bashku kanë shpenzuar 25.379 euro. Nga të dhënat zyrtare konstatohet se Drejtoria e Kulturës ka shpenzuar shumëfish më shumë se sa Zyra e Kryetarit. Ky shpenzim rezulton të jetë i pashpjegueshëm nëse merret parasysh se Drejtoria e Kulturës për nga kompetencat dhe shtrirja është shumëfish më e vogël se Zyra e Kryetarit. 10.169 euro ka shpenzuar Zyra e Kryetarit për derivate për automjete gjatë vitit 2011, ndërsa Drejtoria e Kulturës 17.825 euro. Drejtoria e Kulturës rezulton me shpenzime enorme edhe për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, ku 5.897 euro janë shpenzuar nga Drejtoria e Kulturës në këtë drejtim, përderisa Drejtoria e Shërbimeve Publike brenda së cilës bëjnë pjesë edhe automjetet e zjarrfikëseve ka shpenzuar 3.784 euro, apo 2.113 euro më pak se Drejtoria e Kulturës.

Gjatë nëntëmujorit (janar-shtator) të vitit 2012, Komuna e Gjakovës për dreka dhe darka zyrtare ka shpenzuar 49.144 euro, për karburant për vetura zyrtare 181.768 euro, për naftë për ngrohje 146.590 euro, për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare janë shpenzuar 23.049 euro, ndërsa për mëditje për vizita jashtë vendit 10.365 euro. Shikuar në tërësi gjatë tri viteve të fundit (2010-2012), Komuna e Gjakovës rezulton me shpenzime të larta në disa kategori. Për tri vite për dreka dhe darka zyrtare janë shpenzuar hiq më pak se 152.304 euro, për karburant për automjete janë shpenzuar 394.425 euro, kurse për telefona mobil dhe fiks janë shpenzuar mbi 148.000 euro.

Një praktikë e gjerë e hasur në Komunën e Gjakovës gjatë këtyre viteve ka të bëjë me lidhjen e kontratave nën vlerën e 10.000 eurove, praktikë kjo që nuk i obligon ligjërisht komunat për t'i ndjekur procedurat e tenderimit. Gjatë vitit 2011, Komuna e Gjakovës ka lidhur 106 kontrata përmes procedurave të tenderimit në vlerë të përgjithshme 3.896.914 euro, përderisa për të njëjtën periudhë vetëm për investime kapitale ky institucion ka pasur në dispozicion mbi 5.2 milionë euro, çka tregon se shumatat e shpenzuara pa procedura të tenderimit janë të larta

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në komunën e Gjakovës për periudhën janar 2010 - shtator 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

## 1. Hyrje

Komuna e Gjakovës udhëhiqet nga Kryetari z.Pal Lekaj i cili pozitën e të parit të Komunës e ka fituar duke përfaqësuar subjektin politikë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ai aktualisht po e përmbyll vitin e fundit në mandatin e dytë në pozitën e Kryetarit të Komunës. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Gjakova ka rezultuar t'i ketë 94.556 banorë.<sup>1</sup> Ky numër i banorëve nuk përkon me pritjet e autoriteteve të Gjakovës të cilët kanë supozuar se numri i qytetarëve që jetojnë në këtë komunë është afro 150.000 banorë.<sup>2</sup> Kjo komunë vazhdon të tërheq grant nga niveli qendror mbi numrin e supozuar të banorëve për 115.000 banorë, apo për mbi 20.000 banorë me shumë se numri i banorëve të dal nga regjistrimi i fundit i popullsisë.<sup>3</sup> Ky dallim në shifra do ta tkurr buxhetin e Gjakovës në të ardhmen për mbi 300.000 euro.<sup>4</sup>

Ekzekutivi komunal i Gjakovës përbehet nga 12 drejtori si dhe shtatë zyre përkatëse. Për dallim nga komunat tjera të vendit, Komuna e Gjakovës e ka edhe Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe Drejtorinë për Bujqësi. Drejtoritë tjera janë: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Administratës dhe Personelit, Drejtoria për Punë Inspektuese, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria për Financa, Drejtoria për Urbanizim dhe Planifikim, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria e Gjeodezisë si dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

AAK në Gjakovë ka hyrë në një bashkëqeverisje të gjerë me subjektet tjera politike për të qeverisur Komunën e Gjakovës. Kështu nga 12 drejtori, shtatë udhëhiqen nga AAK, dy nga Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) dhe dy të tjera nga Partia Reformiste (ORA). PSHDK udhëheq me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Partia Reformiste - ORA udhëheq me Drejtorinë

---

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>2</sup> Komuna e Gjakovës. Faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/City-guide/QyteteTriZonaGjakove.aspx>

<sup>3</sup> Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

<sup>4</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikat Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

e Arsimit si dhe me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik. Përfaqësuesit e subjektit politik ORA janë shkrirë në LDK dhe për rrjedhojë koalicioni me AAK në Gjakovë tani llogaritet me LDK dhe me PSHDK.

Kjo bashkëqeverisje mes këtyre subjekteve politike të prira nga AAK shtrihet edhe në Kuvendin Komunal të Gjakovës. Kuvendi përbehet nga gjithsej 41 asambelistë, ku 16 asamblistë nga AAK, pesë nga LDK, tre nga PDK, katër nga PSHDK, dy nga LDD, shtatë nga AKR, dhe me nga një përfaqësues janë të përfaqësuar LIB, PD, PDKI dhe IRDK. Subjektet politike që janë të rreshtuara në krahun e pozitës (ekzekutivit) në Kuvendin Komunal kanë gjithsejtë 25 asambleistë, apo votat e mjaftueshme për votimin e të gjitha akteve komunale. Kjo përbërje e Kuvendit nuk është kompakte ashtu siç ka dal nga zgjedhjet lokale të 2009, ngase në ndërkohe disa asambleistë kanë kaluar nga një subjekt në tjetrin. AAK nga zgjedhjet lokale ka fituar 11 vende në Kuvend të Gjakovës, kurse tani numëron 16 vende pas kalimeve nga partitë tjera.

## 2. Problemet në Komunën e Gjakovës

Komuna e Gjakovës vazhdon të përballet me probleme të natyrave të ndryshme, sikurse: mungesa e kanalizimeve në pothuajse të gjitha zonat rurale, mos rregullimi i rrugëve as në zonat urbane, mungesa e ngrohjes qendrore gjatë sezonit të dimrit, mungesa e trotuareve për këmbësor në shumë zona të qytetit, rritja e numrit të ndërtimeve pa leje në qytet, etj. Një problem tjetër që ka shqetësuar qytetarët e Gjakovës është edhe nisma e Komunës për ndërrimin e kalldrëmit në lagjen e vjetër të Gjakovës, e njohur ndryshe si çarshia e vjetër. Kjo nismë është vlerësuar si tjetërsim i trashëgimisë kulturore të vendit.

“Çarshia e Gjakovës” është konsideruar e veçantë për faktin se shtrimi i saj me kalldrëm daton mbi gjysmë shekulli. Komuna pa ndonjë paralajmërim dhe diskutim paraprakë ka hequr kalldrëmin dhe ka vendosur ta shtrojë me rrasa gurësh. Ky veprim i udhëheqëseve të Gjakovës ka hasur në kritika të gjëra si nga ana e institucioneve ashtu edhe të qytetarëve dhe zejtarëve të Gjakovës. Punimet kanë nisur në muajin korrik të vitit të kaluar (2012) dhe ishte pritur që punimet të përmbylleshin brenda atij viti. Një vendim i Ministrisë së Kulturës i Qeverisë së Kosovës ka bërë që punimet të pezullohen dhe akoma nuk ka ndonjë qëndrim apo vendim të Komunës së Gjakovës se si do të procedohet me tutje më këtë projekt. Një numër i madh i bizneseve është i vendosur pikërisht në atë zonë, ku si rrjedhojë prishja e infrastrukturës paraprake të kësaj rruge dhe mbetja e gjendjes pezull është duke e dëmtuar funksionimin e rregullt të tyre.

Projekti për ristrukturimin e çarshisë është paraparë të kushtojë mbi 1 milionë euro dhe vije në kohën kur shumë zona të qytetit kanë nevojë për investime esenciale në infrastrukturë. Kësisoj rruga “Sadik Pozhegu” që bije në zonat urbane të qytetit nuk është asfaltuar asnjëherë, ndonëse banorët e kësaj lagje disa herë radhazi i janë drejtuar Komunës së Gjakovës me kërkesa.

Dëmtimi dhe vjedhja e pronës publike është një problem tjetër në këtë komunë. Brenda vitit 2012 vetëm në rrugën “Gjon Nikoll Kazazi” janë hequr dhe vjedhur dhjetëra kapak pusetash si dhe shenja komunikacioni gjithandej komunës. Kjo dukuri përveç që dëmton buxhetin e Komunës, vë në rrezik edhe ngasësit e automjeteve dhe qytetarët në përgjithësi.

Në lagjen “Mulla Isufi” Komuna i ka dhënë leje një familjeje për të ndërtuar shtatoren e familjarit të tyre të vrarë në luftën e fundit. Ky vendim i Komunës së Gjakovës ka irrituar banorët e kësaj lagje të cilët prej vitit 2008 deri në vitin 2010 kanë kërkuar disa here nga Komuna lejen për vendosjen e një lapidari për të vrarët e luftës të kësaj ane. Komuna nuk i ka lejuar me arsyetimin se në vendin e paraparë është planifikuar zgjerimi i rrugës. Banorët këtë hap të Komunës e kanë konsideruar si aplikim të standardeve të dyfishta për çka iu kanë drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka shfuqizuar vendimin e Komunës për lejimin e ndërtimit të shtatores.

Territori i Gjakovës në tri vitet e kaluara është mbërthyer nga nisja ndërtimeve të larta (banesave). Shumica nga to nuk ka hapësirë për parking, hapësirë gjelbërimi si dhe kënde për fëmijë, ani pse të gjitha këto janë kushte për marrjen e lejes së ndërtimit.

Në pjesën dërrmuese të fshatrave të Gjakovës nuk është i shtrirë dhe i rregulluar sistemi i kanalizimeve. Kjo i shtynë edhe me tutje banorët e këtyre zonave që ujërat e zeza t’i derdhin vend e pa vend duke rrezikuar kësisoj kontaminimin e ambientit dhe përhapjen e insekteve.

Një problem tjetër i cili po i përcjell gjakovarët tash e disa vite është pamundësia e ngrohjes së qytetit për të ofruar ngrohje konstante gjatë sezonit të dimrit. Ndonëse sasia dhe cilësia e ngrohjes gjatë tri viteve të fundit ka qenë jo e mirë, shumata e shpenzuara nga Komuna e Gjakovës për të paguar ngrohjen qendrore janë të larta, ku mesatarja e shpenzimeve vjetore të Komunës për pagimin e ngrohjes sillet rreth 110.000 euro.

### **3. Performanca buxhetore e Komunës së Gjakovës**

Komuna e Gjakovës llogaritet në mesin e Komunave të mëdha të vendit. Për nga numri i popullsisë, madhësisë së territorit dhe buxhetit, kjo Komunë është e përafërt me Komunën e Pejës dhe atë të Gjilanit.<sup>5</sup> Në vitin 2011 janë realizuar 13.000 euro më pak të hyra vetanake, krahasuar me një vit me herët (2010). Shkalla e të hyrave komunale të Gjakovës është me e vogël krahasuar me Komunën e Pejës dhe atë të Gjilanit. Por, në

---

<sup>5</sup> Në regjistrimin e fundit të Popullsisë Komuna e Pejës ka dale t’i këtë 96.450 banorë, ndërsa Komuna e Gjilanit 90.178 banorë:

[http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

nëntëmujorin e vitit 2012 shuma e përgjithshme e të hyrave ka qenë 2.101.775 euro, apo 25% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.<sup>6</sup>

Komuna e Gjakovës gjatë një viti realizon të hyra për 222.000 euro më pak së Komuna e Pejës, apo mbi 1 milionë euro më pak se Komuna e Gjilanit. Gjakova, ndonëse realizon të hyra më pak se Peja dhe Gjlani, ajo ka buxhet më të madh se këto dy komuna (Peja dhe Gjlani).

Tabela nr.1: Shuma e buxhetit total në tri komunat e përafërta Gjakovë, Pejë dhe Gjilan si dhe të hyrat komunale për vitin 2011

Komunat	Gjakovë	Pejë	Gjilan
Buxheti total	17.973.465	17.632.988	17.509.398
Të hyrat	2.382.000	2.604.000	3.525.000

Nga tabela e mësipërme vihet në pah se Komuna e Gjakovës ka buxhet për 107.870 euro më shumë se Komuna e Pejës apo 625.668 euro më shumë se Komuna e Gjilanit. Buxheti i Komunave përbehet nga të hyrat komunale, nga granti i Qeverisë i paraparë për komunat, nga granti specifikë për arsim, nga granti specifikë për shëndetësi si dhe linja për paga. Komuna e Gjakovës për vitin 2013 ka planifikuar të hyra në vlerë prej 2.9 milionë euro.

Tabela nr.2: Të hyrat komunale në Gjakovë gjatë katër viteve të fundit

Viti	2009	2010	2011	2012 (9 muaj)
Shuma/euro	2.316.000	2.395.000	2.382.000	2.101.775

Shkalla e të hyrave komunale në Gjakovë do të ishte dukshëm me e madhe sikur të ekzistonte një seriozitet me i madh i autoriteteve komunale në vjeljen e të hyrave. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin për vitin 2011 saktëson se ka hasur dy ndërtime të larta në qendër të qytetit të cilat nuk kanë pasur leje ndërtimi.<sup>7</sup> ZAP ka evidentuar parregullsi edhe në menaxhimin e të hyrave nga tregu si dhe në shfrytëzimin e pronës publike.

Komuna e Gjakovës sipas të dhënave zyrtare akoma ka të pa mbledhura rreth 4 milionë euro, borxh ky i qytetarëve dhe subjekteve afariste ndaj komunës që lidhet me mos pagimin e tatimit në pronë. Mos mbledhja e këtij borxhi vlerësohet të jetë një ndër faktorët që ka ndikuar në mos rritjen e shkallës së përgjithshme të të hyrave komunale.

<sup>6</sup> Referimi i të dhënave për nëntë muajt e vitit 2012 ka ardhur ngase të dhënat vjetore nuk kanë qenë të përgatitura deri në fund të muajt janar të vitit 2013.

<sup>7</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Gjakovës. 2011. Fq-12. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGJ\\_2011\\_Shqip\\_92784.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2011_Shqip_92784.pdf)

Sipas raporteve financiare të Ministrisë së Financave në dy vitet e fundit Komuna e Gjakovës ka pasur borxh të konsiderueshëm. Kështu viti 2011 ka nisur me gjithsej 989.140 euro fatura të papaguara, ndërsa vitin 2012 ka nisur me 587.346 euro fatura të papaguara. Lista e faturave të papaguara rezulton të jetë e gjatë dhe ato kryesisht kanë të bëjnë me mos pagimin e derivateve, botimeve, publikimeve, mirëmbajtjes së objekteve dhe automjeteve dhe kategorive tjera të linjës mallra dhe shërbime.

Komuna e Gjakovës në linjën për mallra dhe shërbime gjatë një viti ka në dispozicion mbi 1.5 milionë euro, të cilat shpenzohen në kategoritë e më poshtme.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Gjakovës për vitin 2011

Kategoria	Shuma
Shpenzime për telefon mobil	19.844
Mëditje jashtë vendit	8.903
Derivate për automjetet zyrtare	117.824
Mirëmbajtja e automjeteve	19.384
Dreka zyrtare	39.503
Naftë për gjenerator	3.731
Naftë për ngrohje	182.037
Blerja e druve	64.888
Mirëmbajtja e ndërtesave	170.933
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	17.669
Reklama dhe konkurse	25.898
Botime dhe Publikime	3.917
Furnizim i zyrës	191.985
Furnizim me ushqim dhe pije - (jo dreka zyrtare)	51.109

Tabela nr.4: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në sipas sektorëve dhe Drejtorive në Komunën e Gjakovës për vitin 2011

Sektorët/Drejtoritë	Kategoritë/Shuma				
	Dreka Zyrtare	Derivate për automjete	Mirëmbajtja e automjeteve	Shpenzime në telefonin mobile	Mëditje jashtë vendit
Zyra e Kryetarit	17.448	10.169	3.141	4.669	987
Drejtoria e Administratës	1.479	16.458	398	3.332	831
Zyra e Prokurimit	367	2.017	00	875	122
Drejtoria e Inspekcioni	1.351	6.964	1.388	620	860



Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1.764	7.268	388	3.240	122
Drejtoria e Shërbimeve Publike	5.337	36.499	3.784	1.990	2.053
Zyra Komunale për Komunitete	2.038	1.961	369	889	1.382
Drejtoria për Bujqësia	4.100	7.615	1.123	900	00
Drejtoria e Kadastrit	1.055	3.404	00	470	00
Drejtoria e Urbanizimi	608	1.910	1.001	320	00
Drejtoria e Shëndetësisë	63	1.063	721	840	00
Drejtoria e Kulturës	905	17.825	5.897	1.176	1.192
Drejtoria e Arsimit	2.988	4.671	1.174	523	1.354
<b>Totali</b>	<b>39.503</b>	<b>117.824</b>	<b>19.384</b>	<b>19.844</b>	<b>8.903</b>

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se Drejtoria e Kulturës ka shpenzuar shumëfish më shumë se sa Zyra e Kryetarit. Ky shpenzim rezulton të jetë i pashpjegueshëm nëse merret parasysh se Drejtoria e Kulturës për nga kompetencat dhe shtrirja është shumëfish më e vogël se Zyra e Kryetarit. 10.169 euro ka shpenzuar Zyra e Kryetarit për derivate për automjete gjatë vitit 2011, ndërsa Drejtoria e Kulturës 17.825 euro. Drejtoria e Kulturës rezulton me shpenzime enorme edhe për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, ku 5.897 euro janë shpenzuar nga Drejtoria e Kulturës në këtë drejtim, përderisa Drejtoria e Shërbimeve Publike brenda së cilës bëjnë pjesë edhe automjetet e zjarrfikëseve ka shpenzuar 3.784 euro, apo 2.113 euro më pak se Drejtoria e Kulturës.

Në bazë të raportit vjetor (2011) të Drejtorisë së Kulturës aktivitetet kryesore të mbështetura dhe të realizuara nga kjo drejtori janë:

- Mbështetja e video-klipit të këngëtares nga Drenica – Leonora Jakupi
- Koncert në rastin e tre vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
- Mbështetja e 20 piktoreve për të hapur ekspozitë për 7 marsin
- Organizimi i 47 i festivalit “mitingu i poezisë”

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar edhe kuize për nxënës, hapje ekspozitash kolektive e individuale, turne në futboll e lojëra të tjera, mbështetje dhe promovim librash si dhe premiera të teatrit e qytetit.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Kulturës, Rinise dhe Sportit. Raporti për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/9535d0f3-511b-4f03-b534-87ca3e9869f3/RAPORTI-I-DREJTORISE-SE-KULTURES-RINISE-DHE-SPORTI.aspx>

Tabela nr.5: Krahasimi i Shpenzimeve në disa kategori mes vitit 2010 dhe atij 2011 në Komunën e Gjakovës

Kategoria	Shuma	
	2010	2011
Shpenzime për mëditje	22.875	8.903
Naftë për ngrohje	172.820	182.037
Karburant për gjenerator	1.851	3.731
Karburant për automjete zyrtare	94.833	117.824
Mirëmbajtja e automjeteve	24.329	19.384
Reklama dhe konkurse	23.681	25.898
Dreka Zyrtare	63.657	39.503
Mirëmbajtja e ndërtesave	191.936	170.933
Mirëmbajtja e pajisjeve/mobileve	11.857	17.669
Furnizim i zyrave	169.704	191.985
Blerja e druve për ngrohje	68.040	64.884
Telefoni mobile	16.771	19.844
Telefoni fikse	31.400	36.462

Nga tabela e mësipërme vihet në pah një rritje e konsiderueshme e shpenzimeve në disa kategori, krahasuar mes vitit 2010 dhe atij 2011. Megjithatë ka pasur rënie të shpenzimeve në disa kategori sikurse për mëditje jashtë vendit, në mirëmbajtjen e veturave si dhe në dreka zyrtare, ndonëse shifrat e shpenzuara në këtë drejtim nuk rezultojnë të jenë të vogla.

Tabela nr.6: Prezantimi i shpenzimeve në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2010 dhe krahasimi me vitin 2011

Kategoria	2010	2011
Pagesat për energji elektrike	266.577	283.601
Pagesat për ujë	63.713	65.229
Pagesat për mbeturina	26.770	27.921
Pagesat për ngrohje qendrore	137.428	126.402

Auditori i Përgjithshëm në raportin e tij për vitin 2011 e cilëson anomali mënyrën e pranimit të naftës së kontraktuar nga ana e Komunës së Gjakovës. Komuna e Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 ka paguar 182.037 euro për naftë për ngrohje. Komisioni për pranim të mallit ka bërë pranimin e derivateve, por nuk kishte lënë dëshmi se sasia e furnizuar është në harmoni të plotë me fletë dërgesën e furnizuesit. Komuna nuk ka ofruar dëshmi se komisioni për pranim të derivateve ka bërë matjen e

sasisë së furnizuar të derivateve. Pra, pranimi i derivateve për ngrohje ishte bërë në mungesë të një kontrolli të mirëfilltë.<sup>9</sup>

Tabela nr.7: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Gjakovës për nëntë muajt e vitit 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Mëditje jashtë vendit	10.365
Shpenzime ne telefonin mobile	16.727
Naftë	146.590
Karburant për gjenerator	2.640
Karburant për automjete zyrtare	181.768
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	23.049
Reklama dhe konkurse	6.709
Dreka zyrtare	49.144

Shpenzimet e bëra nga Komuna e Gjakovës në nëntë muajt e vitit 2012 tejkalojnë shumëfish shpenzimet e bëra në të njëjtat kategori gjatë gjithë vitit 2011.


Tabela nr.8: Vlerësimi i totalit të shpenzimeve gjatë vitit 2010 dhe 2011 si dhe në nëntëmuajorin e vitit 2012 në disa kategori nga Komuna e Gjakovës

Kategoria	2010	2011	2012 (9 muaj)	Totali
Dreka Zyrtare	63.657	39.503	49.144	<b>152.304</b>
Telefoni mobile	16.771	19.844	16.727	<b>53.342</b>
Telefoni fikse	31.400	36.462	26.935	<b>94.797</b>
Mëditje jashtë vendit	22.875	8.903	10.365	<b>42.143</b>
Naftë	172.820	182.037	146.590	<b>501.447</b>
Karburant për automjete zyrtare	94.833	117.824	181.768	<b>394.425</b>
Karburante për gjenerator	1.851	3.851	2.640	<b>8.342</b>
Mirëmbajtja e automjeteve	24.329	19.384	23.049	<b>66.762</b>

Për vitin 2013, Komuna e Gjakovës do të ketë në dispozicion 19.021.254,00 euro. Pjesa me e madhe e tyre janë paraparë të shpenzohen në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, apo 53.7%, pastaj në kategorinë e investimeve kapitale do të dedikohen 31.6% e

<sup>9</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Gjakovës. 2011. Fq-13. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGJ\\_2011\\_Shqip\\_92784.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2011_Shqip_92784.pdf)

buxhetit, ndërsa kategoria e mallrave dhe shërbimeve merr 8.19%, kategoria e shpenzimeve komunale 3.65% dhe 2.88% në kategorinë e subvencione.<sup>10</sup>



Burimi: [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

## 4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Gjakovës janë fokusuar kryesisht në rregullimin e rrugëve duke përfshi rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre. Mbeten të pamjaftueshme investimet në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit si dhe në rregullimin e kanalizimeve. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Gjakovës gjatë një viti për investime kapitale sillet mbi 6 milionë euro.

Tabela nr. 9: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Gjakovës të realizuara gjatë vitit 2010 -2011 dhe 2012


Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Ndërtimi i parkut në qendër të qytetit - "Faza II"	25.741
Asfaltimi i rrugës në fshatin Osek Pashë	166.585
Asfaltimi i rrugës lokale Ramoc-Korenicë	407.263
Asfaltimi i rrugëve "Dukagjin Vula" dhe "Xhafer	153.274

<sup>10</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Buxheti i Kosovës. Raporti mbi ndarjen dhe shpenzimin e parasë publike. Burimi: [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Thaqi" në lagjen "Dardania"	
Ndërtimi i urës në fshatin Bardosanë	8.923
Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Babaj Bokës-Erenik	74.552
Asfaltimi i rrugës në fshatin Dujakë	43.169
Asfaltimi i rrugës në fshatin Dol-lagja "Bardheci"	249.376
Asfaltimi i rrugës në lagjen "Pepaj" në fshatin Brekoc	284.266
Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Smolicë	98.000
Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Moglicë	105.855
Asfaltimi i rrugës në fshatin Meje	93.619
Asfaltimi i rrugës Rripaj-Jahoc	148.435
Asfaltimi i rrugës në fshatin Plançor	228.608
<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Asfaltimi i rrugëve "Lidhja e Prizrenit", "Abdurrahim Buza" dhe "Tomë Gjoka" në Gjakovë	284.960
Asfaltimi i rrugës në fshatin Sheremet-lagja "Bojaj"	33.326
Asfaltimi i rrugës në fshatin Orize-Meje	78.870
Asfaltimi i rrugës në fshatin Guskë	129.360
Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Novosellë e Poshtme	171.717
Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Vraniq	77.332
Rregullimi i rrugës "Dëshmorët e Lirisë"	689.470
<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Ndërtimi i urës për këmbësorë mbi lumin Krena në rrugën "Dëshmorët e Lirisë"	11.858
Asfaltimi i rrugës në fshatin Brovinë	97.696
Asfaltimi i rrugës lokale Madanaj-Rripaj	169.563
Shtruarja me kubëza betoni e rrugëve dhe trotuareve të Gjakovës	946.901
Riparimi i urës automobilistike në segmentin e rrugës "Sadik Stavileci" në Gjakovë	15.918
Rregullimi i rrjedhjes së lumit Erenik për mbrojtjen e pendës në fshatrat Babaj Bokës dhe Smolic nga erozioni	14.645
Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Shishmon-Mazrek	193.002
Ndërtimi i ujësjellësit për 12 fshatrat e Rekës së Keqe	1.655,980

Nga tabelat e mësipërme vihet në pah se gjatë tri viteve të fundit, pjesa më e madhe e projekteve në sferën e investimeve kapitale janë fokusuar në zonat rurale të kësaj komune. Kjo është adresuar si kritikë edhe në Kuvendin Komunal të Gjakovës nga ana e subjekteve opozitare, por ekzekutivi i ka mbrojtur këto investime me pohimin se në vazhdimësi pas lufte është investuar në zonat urbane dhe kësaj deri vonë kanë mbetur anash investimeve zonat rurale të kësaj komune. Për 2013 nga Komuna e Gjakovës janë

paraparë mbi 6 milionë euro investime kapitale. Grafikoni i mëposhtëm shpjegon sferat e parapara për investime në 2013 nga Komuna e Gjakovës.<sup>11</sup>



## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Gjakovës fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka gjithsejtë katër të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për tri vite (2010-2012) Komuna e Gjakovës ka lidhur 308 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave afro 12 milionë euro.

Tabela nr.10: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Gjakovës 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	115	5.306.121.22

<sup>11</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Buxheti i Kosovës. Raporti mbi ndarjen dhe shpenzimin e parasë publike. Burimi: [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

<b>2011</b>	106	3.896.914.99
<b>2012</b>	87	2.610.225.21
<b>Totali</b>	308	11.813.261,42

Për vitin 2012 të dhënat përfshijnë vetëm nënujorin (janar-shtator)

Auditori i Përgjithshëm në raportin e tij për vitin 2011 konstaton se gjatë vitit 2011 Komuna i ka bërë tri pagesa operatorit ekonomik në shumë prej 134.831 euro në emër të furnizimeve me farë misri, gruri dhe plehra artificial. Auditori nuk ka gjetur se operatori, përkatësisht furnizuesi është përzgjedhur në bazë të aplikimit të procedurave të prokurimit. Furnizimi është bërë duke anashkaluar çdo procedurë të prokurimit. Po ashtu, Komuna nuk i kishte bërë kriteret e qarta që duhej t'i plotësonin përfituesit. Gjithashtu, me datën 14.04.2011 ishte paguar fatura e datës në vlerë prej 8.160 euro në emër të kalendarëve të shtypur. Auditori nuk ka gjetur dëshmi se në çfarë mënyre është përzgjedhur operatori për t'i shtypur këta kalendar.<sup>12</sup>

Rastet e shkeljeve të rregullave të prokurimit publik nga ana e autoriteteve të Komunës së Gjakovës janë konstatuar disa herë radhazi edhe nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Vendimi i fundit i këtij organi ndaj komunës së Gjakovës ka të bëjë me mirëmbajtjen e objektit të Komunës, ku pas marrjes së një ankese, OSHP ka urdhëruar Komunën e Gjakovës që të anulojë tenderin me arsyetimin e shpërfilljes së rregullave të prokurimit.<sup>13</sup> Në një rast tjetër, OSHP ka urdhëruar Komunën e Gjakovës që të anulojë një kontratë të lidhur me një operator privat për mbikëqyrjen e punimeve në terren. Anulimi i kësaj kontrate ka ardhur pas evidentimeve që vlerësimi i çmimit për punën që pritet të kryhet nuk ka qenë i saktë.<sup>14</sup>

## 6. Administrata e Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka gjithsej 331 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë zjarrfikësit dhe të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në teatrin e qytetit. Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike është 1.977 persona.

<sup>12</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Gjakovës. 2011. Fq-14. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGJ\\_2011\\_Shqip\\_92784.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2011_Shqip_92784.pdf)

<sup>13</sup> Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Datë 05.11.2012. nr. 297/12. Burimi: <http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Mirembajtja-e-objekteve-te-Komunes-se-Gjakoves.pdf>

<sup>14</sup> Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Datë 24.10.2012. Nr. 289/12. Burimi: <http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Mbikqyrja%20e%20projekteve%20profesionale.pdf>

Tabela nr.11: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Gjakovës dhe vështrimi gjinor

Sektorët	Numri i të punësuarve	M	F
Zyra e Kryetarit	7	6	1
Drejtoria e Administratës	58	41	17
Drejtoria e Inspektionit	26	25	1
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	31	22	9
Drejtoria për Shërbime publike	8	6	2
Drejtoria për Mbrojtje dhe shpëtim/zjarrfikës	58	55	3
Zyra për Komunitete	5	4	1
Drejtoria për Bujqësi	17	16	1
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	16	14	2
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster	19	13	6
Drejtoria e Urbanizimit	17	8	9
Drejtoria e Shëndetësisë	8	5	3
Drejtoria e Arsimit	12	7	5
Drejtoria për Kulturë	22	19	3
Qendra për Punë Sociale	17	9	8
Teatri i qytetit	5	5	0
Biblioteka komunale	5	1	4
<b>Gjithsejtë</b>	<b>331</b>	<b>256</b>	<b>75</b>

Vlen të përmendet se tri Drejtori më rendësi në Komunën e Gjakovës udhëhiqen nga femrat, përkatësisht Drejtoria e Arsimit, ajo e Urbanizimit si dhe Drejtoria e Gjeodezisë. Për dallim nga administrata komunale, ku numri i femrave të punësuarave rezulton i vogël, në sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë janë hasur shifra inkurajuese për sa i takon punësimin të femrave.

## 7. Arsimi në Komunën e Gjakovës

Komuna e Gjakovës konsiderohet e përafërt me Komunën e Prishtinës për nga numri i çerdheve për fëmijë dhe për numri i shkollave fillore. Gjithsejtë janë shtatë çerdhe publike në Gjakovë, përderisa në Prishtinë gjenden tetë të tilla. Komuna e Gjakovës ka 39 shkolla fillore dhe nëntë shkolla të mesme. Në Gjakovë ekzistojnë të gjitha profilet e shkollimit të mesëm, gjimnaz matematikor, gjimnaz natyrorë, shkolla teknike profesionale, shkolla e bujqësisë e ekonomisë, profili i tregtisë si dhe profili i filologjisë.



Tabela nr.12: Numri i fëmijëve dhe i personelit në shtatë çerdhet e Gjakovës dhe vështrimi gjinor

Numri i fëmijëve	F	M	Numri i edukatoreve	F	M	Personeli ndihmës	F	M
571	260	311	46	46	0	27	20	7

Tabela nr.13: Numri i mësimdhënëseve dhe stafit përcjellës në 39 shkollat fillore të Gjakovës:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	553	48	151	12
Meshkuj	418	163	147	39
<b>Gjithsejtë</b>	<b>971</b>	<b>211</b>	<b>298</b>	<b>51</b>

Tabela nr.14: Numri total i mësimdhënëseve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 39 shkolla fillore dhe nëntë shkolla të mesme në Komunën e Gjakovës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	1.269	704	565
Nxënës	22.158	10.354	11.804
Stafi ndihmës	262	60	202

Tabela nr.15: Numri total i të punësuarve në sektorët që mbulojnë nga Komuna e Gjakovës

Sektorët	Numri
Komuna e Gjakovës	331
Arsimi fillor dhe i mesëm	1.269
Çerdhet	73
Shëndetësia	304
Totali	1.977

Investimet në infrastrukturën e shkollave të Gjakovës kryesisht janë fokusuar në riparimin e kulmeve, riparimin dhe transformimin e sistemit të ngrohjes, renovime të brendshme të shkollave, ndërrimin e dyerve dhe dritareve dhe gëlqerosje të objekteve.<sup>15</sup> Ndërtim të shkollave të reja nuk ka pasur, me përjashtim të ndërtimit të objektit të ri të gjimnazit "Hajdar Dushi" i cili është bërë në bashkëfinancim mes Komunës së Gjakovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

<sup>15</sup> Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Arsimit. Raporti i punës i Drejtorisë së Arsimit. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/5ba0be0c-f5f7-47a6-a247-ad5fb03c5efd/Drejtoria-e-Arsimit-Rapori-i-punes-per-periudhen-I.aspx> & <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/c5f026dc-4148-4f1b-ac42-086fa66e614f/Drejtoria-e-Arsimit-Raport-pune-Janar---Prill-2012.aspx>

## 8. Shëndetësia në Komunën e Gjakovës

Sistemi i shëndetësisë në Komunën e Gjakovës ka një shtrirje të gjerë dhe mbulon gjithë territorin e komunës. Kjo komunë përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) disponon edhe me tetë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe me 15 punkte shëndetësore apo ambulanca. Në brendinë e qytetit të Gjakovës është funksional edhe spitali rajonal i quajtur “Isa Grezda”. Spitali nuk është nën menaxhimin e Komunës së Gjakovës, por menaxhohet nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Në Gjakovë funksionon edhe qendra për shëndet mental dhe shtëpia mbrojtëse për rastet psikiatrike, e po ashtu edhe dega e Institutit Kombëtarë për Shëndet Publik si autoritet që ka përgjegjësinë e analizës dhe monitorimit të situatës higjienik-epidemiologjike të qytetit. Të tri këto institucionet e fundit menaxhohen nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Spitali rajonal në Gjakovë “Isa Grezda” ka në dispozicion 490 shtretër në dhjetë reparte ku janë të angazhuar 59 mjekë specialist, 280 infermier dhe rreth 30 teknik. Spitali ofron shërbime në fushën e kirurgjisë, gjinekologjisë, urologjisë, mjekësisë interne, ortopedisë, oftamologjisë, infektives, pulmologjisë, pediatrië dhe neuropsikiatrië.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare funksionin në qendër të qytetit, ndërsa Qendrat e Mjekësisë Familjare janë të shpërndara, ku një e tillë gjendet në lagjet Qabrat dhe Orize, pastaj në fshatrat Rugovë, Ponoshec, Skivjan, Cermjan, Dujak. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë që mbulohet nga Komuna e Gjakovës është 304 persona.

## 9. Transparenca në Komunën e Gjakovës

Vlerësimet e deritanishme të bëra nga Instituti GAP në piken e transparencës së komunave e nxjerrin Komunën e Gjakovës si njëren ndër komunat më transparente në vend. Ueb faja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna dhe po ashtu janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëmin e të hyrave ashtu edhe atë të shpenzimeve të parëse publike. E kënaqshme ka qenë edhe përgjigja e Komunës në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Po ashtu vlerësohet e kënaqshme edhe sasia e informatave që korrespondent e medieve të shkuara marrin nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. Media qendrore elektronike (RTK, KTV dhe RTV21) bëjnë pasqyrime të rralla nga kjo komunë dhe pasqyrimet e hasura janë kryesisht jashtë natyrës së qeverisjes lokale. Pasqyrime të detajuara për zhvillimet në Komunë të Gjakovës bëjnë mediat lokale, si televizioni dhe radio “Dukagjini” me seli në Pejë dhe Prishtinë, televizioni “Syri Vision”, Radio “Gjakova”, si

dhe gazeta lokale "Gjakova Press". Këto media mbulojnë gjerësisht zhvillimet e përditshme në Komunën e Gjakovës si dhe pasqyrojnë kohë pas kohe problematikat e ndryshme në këtë komunë.

Tabela: nr.16: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Gjakovës  
<http://kk.rks-gov.net/gjakove/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	√	x	x	x	X	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	X	x	√	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	√	x	X	x	√	√	√	√	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	X	x	√	√	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	√	x	X	x	x	x	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	√	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	X	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Shërbime Publike	x	x	x	x	x	X	x	√	x	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	√	x	X	√	√	x	x	√	x
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	√	x	X	x	√	√	x	√	x
Drejtoria e Bujqësisë	x	x	x	x	x	X	x	√	√	√	√	x
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	x	x	X	x	√	x	x	√	x
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	x	x	x	√	x	X	x	x	x	x	√	x
Zyra e Prokurimit			√				√				√	
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm			X				x				x	
Procesverbalet e Kuvendit Komunal			X				x				x	
Rregulloret Komunale			√				√				√	
Vendimet e Kuvendit Komunal			√				√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal							√					
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	
Planet dhe Strategjitë e Komunës							√					

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Pal Lekaj, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 25 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Gjakovës, 12 premtime janë përmbushur, 9 nuk janë përmbushur, ndërsa në 4 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

Premtimet e dhëna	Realizueshmëria
Ofrimin e kredive të volitshme në bankat e Kosovës dhe ato perëndimore për afaristet dhe biznesmenët të cilët si garantues të parë do ta kenë komunën.	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim dhe kjo politikë nuk mund të rregullohet dhe ndikohet nga qeverisja e nivelit lokal.
Rimëkëmbjen e ekonomisë gjakovare.	Nuk mund të bëhet fjalë për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe planet komunale në këtë drejtim nuk mund të kenë efektin e dëshiruar, ngase rimëkëmbja e ekonomisë është më shumë politik (kompetencë) e nivelit qendror.
Krijimin e 7.000 deri në 8.000 vendeve të reja të punës për 4 vitet e ardhshme.	Nuk është bërë.
Përmirësimin e pozitës së pensionisteve.	Nuk është bërë asgjë nga komuna për përmirësimin apo se paku trajtimin e kësaj çështje. Kjo politikë nuk është ekskluzivisht komunale, por do të mund të trajtohet në forma të tjera, si krijimi i parqeve/vendeve të parapara në mënyrë të veçanët për pensionistë, lirimi i pensionisteve nga pagesa e trafikut urban dhe disa shërbimeve komunale e kështu me radhë, por në këto drejtim nuk është punuar.
Formimin e një Drejtorie të posaçme për intensifikimin dhe fokusimin e zhvillimit ekonomik.	Kjo Drejtori është formuar në Komunën e Gjakovës, prandaj mund të merret si premtim i përmbushur.

Ofrimin e ndihmës financiare ndaj bizneseve të reja dhe rritjen e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në 6000.	Asnjë ndihmë financiare ndaj biznesit nuk ka ekzistuar nga ana e komunës. Aktualisht të regjistruara në territorin e Komunës së Gjakovës rezultojnë 5.72 biznese.
Ndarjen e një buxheti prej 200.000 euro për zhvillimin e ekonomisë familjare dhe formimin e një grupi koordinues që do t'i identifikojë ekonomitë familjare që nuk janë të regjistruara.	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim dhe as që ka pasur nisma të kësaj natyre.
Rritjen e partneritetit publiko-privat.	Ka pasur nisma në këtë drejtim në disa fusha, veçmas në atë të ndërtimit të objekteve të banimit dhe atyre afariste.
Formimin e zyrës për investime të huaja.	Nuk është bërë.
Ndihmë për familjet e dëshmoreve, martireve dhe invalidëve.	Në këtë drejtim ka pasur përkrahje solide, ku kanë përfituar individët e ndryshëm nga kategoria e invalidëve dhe familjeve të dëshmoreve, por nuk ka fond të veçanët komunal të ndarë apo të paraparë për këtë qellim.
Avancimin e pozitës së femrës.	Në Komunë të Gjakovës tri Drejtori Komunale udhëhiqen nga femrat. Femrat në këtë komunë veçmas në arsim dhe shëndetësi janë dominuese për nga numri.
Ndërtimin e një qendre të zhvillimit të biznesit dhe një thertoreje të shpezëve, ku do të punësohen të rinj.	Asnjëra nga këto nuk është bërë. Ish thertorja e shpezëve që ka ekzistuar me herët në fshatin Bec tani është jo funksionale.
Subvencionimin e fermave bujqësore.	Përgjithësisht kjo është bërë dhe ka pasur edhe fond të veçanët komunal në këtë drejtim.
Rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimin e të gjitha rrugicave të fshatit (në vitin e parë të mandatit).	Kjo nuk është përmbyllur si premtim, ndonëse rregullimi i asfaltit dhe kanalizimit ka pasur një ecuri progresive. Shembull për këtë mund të merren rrugët të cilat akoma nuk janë asfaltuar si ajo Krelan – Rakovice.
Asfaltimin e rrugës Krelan-Shqiponjë	Nuk është realizuar.

Asfaltimin e rrugëve të mbetura në Reken e Keqe (në gjashtë mujorin e parë të mandatit).	Përgjithësisht kjo është realizuar.
Ndërtimin e një impianti për ujera të zeza.	Një impiant për ujera te zeza është ndërtuar në Skivjan.
Ndërtimin e kanalizimit në fshatin Lugbunar.	Kjo është realizuar.
Mbylljen definitive të deponisë ekzistuese të mbeturinave brenda 5 muajve dhe zhvendosjen e saj në Landovice.	Deponia është mbyllur, por mbeturinat kanë mbetur dhe mbeturinat vazhdojnë të digjen në ish deponin duke shkaktuar kështu ndotje të ambientit dhe rrezik potencial për banorët përreth.
Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për 24 fshatrat e Rekës së Keqe.	Kjo është realizuar.
Sigurimin e ujit të pijshëm dhe rregullimin dhe kompletimin e memorialit të dëshmoreve në fshatin Shqiponjë dhe Dushkajes.	Kjo është realizuar.
Ndërtimin e rrjetit të ngrohtores në tërë bllokun e ri.	Nuk është realizuar.
Mirëmbajtjen e rregullt të shtratit të lumenjve.	Mirëmbajtje të rregullt nuk ka pasur, ka pasur një mirëmbajtje njëherë në dy vite.
Ndërtimin e shtratit të lumenjve Lukac dhe Krena.	Është bërë pjesërisht.
Punimin e studimit mbi rrezikshmërinë e përmytjeve dhe punimin e hartave të rrezikut.	Kjo është realizuar.

## 11. Burimet:

1. Komuna e Gjakovës. Raporti Financair janar – dhjetor 2010.
2. Komuna e Gjakovës. Raporti Financair janar – dhjetor 2011.
3. Komuna e Gjakovës. Raporti Financair janar – shtator 2012.
4. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Administrates se Pergjithshme. Lista e të punësuarëve ne administraten dhe organet komunale.
5. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Shendetesise dhe Mireqenies Sociale. Lista e te punësuarëve ne sektorin e shendetesise.
6. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Arsimit. Lista e te punesuarëve ne sistemin arsimor të Komunës së Gjakovës.
7. Komuna e Gjakovës. Planifikimi i buxhetit të Komunës së Gjakovës 2012-2014.
8. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>
9. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
10. Raportet vjetore 2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90)
11. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Gjakovës. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=66570>
12. Zyra e Auditorit të Përgjithshem. Raporti i Auditimit për vitin 2011 për Komunën Gjakovës. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGJ\\_2011\\_Shqip\\_92784.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2011_Shqip_92784.pdf)
13. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Gjakovës. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
14. Komuna e Gjakovës. Faqja zyrtare. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/>
15. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Arsimit. Raportet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/5ba0be0c-f5f7-47a6-a247-ad5fb03c5efd/Drejtoria-e-Arsimit-Rapori-i-punes-per-periodhen-J.aspx>
16. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Shëndëtësisë. Raportet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/056e067a-1efa-4985-8a46-6de895763613/Drejtoria-e-Shendetesis-dhe-Mirqenjes-Sociale---Ra.aspx>
17. Komuna e Gjakovës. Drejtoria për Politikë e Financa. Raportet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/ef3d33c9-d494-482f-b375-cf1c9d929c4c/Drejtoria-per-Bugjet-dhe-Financa---Raport-Janar---.aspx>
18. Komuna e Gjakovës. Drejtoria e Administrates. Raportet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/58ba076d-14cf-4dda-ac97-d0bc7bcf51c5/Drejtoria-e-Administrates-dhe-Personelit---Raport-.aspx>

19. Agjencia e Statistikave te Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
20. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)
21. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikat Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>